



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 760/1 Prot.

Tiranë, më 16.11 2016

V E N D I M

“Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar”

Nr. 02, datë 16/11 2016

Në mbështetje të nenit 8, 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr.760 prot, datë 07.07.2016, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi** në marrësin Mylan Inc- Marok

K O N S T A T O V A :

Subjekti kontrollues, **BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi** ka kërkuar nga zyra e Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin **Mylan Inc** të vendosur në Marok.

Sipas deklarimeve të subjektit në *Formularin e Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave*, administruar pranë zyrës së Komisionerit me nr. 760 prot, datë 07.07.2016, transferimi që kërkohet të autorizohet nga zyra e Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi janë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Jeta profesionale;
- Situata ekonomike e financiare;
- Formimi-diplomat-medaljet;
- Adresa, karakteristikat e banesës;
- Foto.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Marok.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë: Punëmarrës.

Frekuenca e Transferimit është: Periodikisht.

Qëllimi i transferimit, citojmë: “Qëllime të përgjithshme menaxhimi të burimeve njerëzore, (psh, për shpërndarjen e pagave dhe përfundimeve, për të lehtësuar komunikimet, për arritjet, vlerësimet, planifikimin), të përmbushjes së detyrimeve të kontratës së punës dhe politikave të

punës së BGP. Ky transferim të dhënash kryhet nga kontrolluesi pasi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të punëdhënësit të përcaktuara në rregullat dhe politikat e punës së tij, të cilat janë të parashikuara si pjesë integrale e kontratës së punës të punëdhënësit me punonjësit e tij”.

Ndërkohë në rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit *”Rrethanat lidhur me përpunimin”* subjekti transferues ka deklaruar, citojmë:“ Përpunimi ndodh në drejtimin e kontrolluesit të të dhënave të cilët kanë ekzekutuar marrëveshje në bazë të Klauzolave Standarde Kontraktuale të Komisionit të BE-së. Çdo punëmarrës ka nënshkruar pëlqimin paraprak nëpërmjet *”Deklaratës për Dhënie Pëlqimi Për Përpunim dhe Transferim Ndërkombëtar të të Dhënave Personale”*. Gjithashtu, BGP ka parashikuar edhe pëlqimin e shprehur në parashikimet e kontratës individuale të punës me çdo punonjës, për transferimin e të dhënave personale të punonjësve në grupin e shoqërive të Mylan kudo në botë”.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: “7 vjet”.

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” Maroku nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Për këtë qëllim subjekti përveç Formularit të Aplikimit ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

Kontratën për transferimin e të dhënave, *”Marrëveshje brenda grupit mbi transferimin dhe përpunimin e të dhënave, e rishikuar dhe e amenduar..”*, Anex Klauzola Standarde Kontraktuale, Shtojca 1,2,3, dhe 4 *”Deklaratën e pëlqimit të punëmarrësve, gjithashtu dhe kontratën e punës me punëmarrësit”*.

Në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, subjekti kontrollues BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi është në kushtet ku ky transferim mund të realizohet pa marrë paraprakisht Autorizimin nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezulton që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi, është në kushtet ku ky transferim mund të kryhet në marrësin e deklaruar sipas Formularit të Aplikimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale kontrolluesit BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi BGP Products Switzerland GmbH Zyrë Përfaqësimi lejohet të transferojë sa herë të jetë e nevojshme, tek marrësi i të dhënave Mylan Inc- Marok kategorinë e të dhënave personale:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
 - Jeta profesionale;
 - Situata ekonomike e financiare;
 - Formimi-diplomat-medaljet;
 - Adresa, karakteristikat e banesës;
 - Foto.
2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë zyrës së Komisionerit dhe që ka të bëjë me përmbushje të detyrimeve të kontratës së punës dhe politikave të punës së BGP.
 3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1) do të mbahen nga marrësi i tyre jo më gjatë sesa nevojiten për përmbushjen e qëllimeve ligjore sipas Formularit të Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë zyrës së Komisionerit.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall, sot më datë 10/11 2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI